



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. ____ Prot

Dt. ____ . ____ . 2026

MIRATOHET

KRYETARI

MAJLINDA CARA

RELACION DHE SPECIFIKIME TEKNIKE

Objekti: “Lyerje, meremetime, riparime elektrike dhe hidraulike te Shkollave”

Bazuar në regjistrin e prokurimit të Bashkisë Kurbin me nr .773 prot. dt. 12.02.2026, qe konsiston në verifikimin e problematikave të shkollave në territorin e Bashkisë Kurbin u konstatuan 20 (njwzetë) shkolla që kanë nevojë për punime riparimi dhe bojatisje . Si rezultat i konstatimeve nga specialistët e Drejtoris së Arsimit,Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ne bashkpunim me specialist te D.P.K.ZH.T-së, kete vit do te trajtohen me punime te riparimit pjesor dhe bojatisje shkollat e mëposhtme:

1. Gjimnazi “At Shtjefën Gjeçovi, Laç
2. Shkolla 9 vjeçare Mark Trokthi, nr.1, Lac
3. Shkolla 9 vjeçare Gjin Pjetri, Lac
4. Shkolla 9 vjeçare nr.3, Lac

5. Shkolla 9 vjeçare Migjeni, Mamurras
6. Shkolla 9 vjeçare “Besnik Sylaj”, Mamurras
7. Shkolla 9 vjeçare Ismail Dema, Fushë Mamurras
8. Shkolla 9 vjeçare, Zhejë
9. Shkolla 9 vjeçare Shullaz
10. Shkolla 9 vjeçare, Skuraj
11. Shkolla 9 vjeçare Vinjollë
12. Shkolla 9 vjeçare Fushë Kuqe
13. Shkolla 9 vjeçare Adriatik
14. Shkolla 9 vjeçare Nikoll Miri, Gurëz
15. Kopshti nr.1, Laç
16. Shkolla 9 vjeçare Dan Bajrami, Gjërem
17. Shkolla Arif Sulaj, Mamurras
18. Shkolla Fushe Milot
19. Shkolla 9 vjeçare Gjok Elezi, Sanxhak
20. Shkolla 9 vjeçare Gjon Gjonaj, Lac

Në bashkëpunim me drejtorite përkatëse të shkollave duhet të meren masa për lirimin e ambjenteve nga mobiljet, për të mos patur dëmtime të tyre dhe sigurimin e një ambjenti tjetër pa cënuar procesin mësimor.

Riparimet dhe lysterjet do të bëhen për mbarvajtjen e procesit mësimor, krijimin e kushteve higjienike për nxënësit dhe mësuesit. Nga konstatimi u vërejt që është e nevojshme riparimi i sipërfaqeve të demtuara të suvatimit , me punime prishje dhe suvatimi pjesor i mureve të brendëshme dhe atyre të jashtme rast pas rasti ku përfshihen kollonat e dyerve e dritareve (qoshet e tyre),tavanet, bojatisja e ambjenteve të brendshme dhe fasadave të jashtme duke ruajtur të njëjtën pamje vizuale pra vetëm

rifreskim i gjendjes ekzistuese gjithashtu lyerja me boje vaji i brezave te klasave dhe korridoreve sipas rastit per cdo shkolle , po ashtu riparime ne taraca .

Suvatim i jashtëm në rikonstruksione Stukim dhe sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin. Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Sprucim i mureve dhe tavaneve për muraturë të pastruar me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin. Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me dozim për m²: rërë e larë 0,005 m³; llaç bastard 0.03 m³; çimento 400, 7.7 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

Më tej do procedohet me këto zëra punimesh sipas nevojave të parashikuara per ndërhyrje imediate në preventivat përkatës dhe duke respektuar grafikun e punimeve bashkangjitur këtij relacioni .

Preventivi i hartuar mund te ndryshohet ne volume gjate zbatimit te punimeve , ne bashkepunim me investitorin , Bashkia Kurbin .

Dokumentimi i punimeve nga ana e ndertuesit qe merr persiper kryerjen e punimeve sipas kushteve teknike dhe nevojave per ndryshim qe dalin gjate zbatimit te punimeve .

Zerat e punimeve ne preventiv jane sipas manualeve teknike dhe punimet do te kryhen referuar kushteve teknike te zbatimit ne fuqi si dhe sigurimin teknik për mbrojtjen e jetës njerëzore.

Lyerje me bojë hidro plastike e sipërfaqeve të brendshme Proçesi i lyerjes me bojë hidro plastike i sipërfaqeve të mureve të brendshme kalon nëpër tre faza si më poshtë:

-Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet. Para lyerjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me ane të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për paralyerje. Në rastet e sipërfaqeve të patinuara bëhet një

pastrim i kujdesshëm i sipërfaqes. Para fillimit të procesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen. (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse. 2

- Lyerja me bojë hidroplastike e sipërfaqeve të brendshme. Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidroplastike e cila është e paketuar në kuti. Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzierje i hidhet pigmenti derisa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizioni I punimeve dhe pastaj bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar.

Punimet qe do te kryhen jane punime Brenda dhe jashte ndertesave .

Punime te brendshme

- 1.Suvatim mure tulle me krah (% e sipërfaqes)
- 2.Bojatisje me gelqere të shuar
- 3.Boje vaji mbi sipërfaqe të patinuar
4. Boje Hidroplastike

Punime te jashtme

- 1.Suvatim mure tulle me krah (% e sipërfaqes)
- 2.Bojatisje me gëlqere te shuar
- 3.Boje Hidroplastike (fasada kryesore)
- 4.Bojatisje me gëlqere të shuar (muri rrethues)
6. Riparime hidroizolimi

Do procedohet duke respektuar preventivin përkatës bazuar ne vkm 216 dt 13.04.2023 “Per miratimin e manualit te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizes teknike te tyre” si dhe grafikun e punimeve . Të gjithë punimet duhet të kryehen duke mbajtur të pastër ambjentin ku punohet .duke respektuar normat dhe standartet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve te ndertimit dhe sigurinë në punë.

Per realizimin e punimeve sipas preventivit eshte i nevojshem nje staf prej 30 (tridhjetë) punonjeshish, i perbere nga: Inxhinier ndertimi, drejtues teknik i punimeve. Ne stafin e

punonjesve duhet te kete punetore te thjeshte ndertimi, specialiste per suvatime dhe punime bojatisje.

Per realizimin e punimeve me sukses jane te domosdoshme keto makineri e paisje:

- Automjet transporti (3- 5) ton ----- 2 cope
- Kamionçina ----- 3cope
- Motobetoniere 250 l ----- 4 cope
- Pompe uji ----- 4 cope
- Autobot uji ----- 1 cope
- Mjete e vegla pune suvatimi e bojatisje
- Skeleri + armatura derrase 1000 m²

Punimet do te kryhen per 30(tridhjetë) dite pune nga data e fillimit te punimeve.

Kompania ndertuese duhet te jete e pajisur me liçense teknike me kategorite e nevojshme per kryerjen e ketyre punimeve N.P- 2 dhe N.P- 3 .

Për D.A.K.R.S

Për D.P.K.ZH.T
